



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.GJA.nr.1/2023-53

Me datë 03.07.2023

KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

***RAPORTI PËR PUNËN E GJYKATËS THEMELORE DHE DEGËVE TË SAJ NË
DRAGASH DHE SUHAREKË PËR TRE MUJORIN E II-të (PRILL – MAJ – QERSHOR
2023)***

Në kuptim të nenit 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.5 të Ligjit për Gjykatat, paraqes raportin për tre mujorin e II-të (PRILL – MAJ – QERSHOR 2023).

Marrë në përgjithësi në aspektin e efikasiteti dhe zgjidhjes së lëndëve, Gjykata Themelore në Prizren ka një rritje të efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve në shumicën e departamenteve dhe divizioneve.

Duhet të cekim se sipas vendimit të KGJK-së, Gjykata Themelore në Prizren ka pranuar në kompetencë dhe punë 11 lëndë në Departamentin e Krimeve të Rënda nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, këto lëndë janë ndarë dhe menjëherë caktuar tek Gjyqtarët, të cilët janë udhëzuar që ti trajtojnë këto raste, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe palët në procedurë që të mos ketë seanca jo produktive dhe dështim të seancave të paarsyeshme, tashmë Gjyqtarët kanë caktuar seancat fillestare, apo seancat e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata Themelore në Prizren pas një riorganizimi, ka një ritëm të punës që qon në trend pozitiv sa i përket rezultatit dhe efikasiteti dhe organizimit dhe shpërndarjes së punës.

Nga data 1 Maj 2023, 2 (Dy) Gjyqtarë në Prizren, kanë filluar angazhimin e tyre dhe të cilët janë caktuar në Divizionin Civil, duke parë nevojën për trajtimin e këtyre rasteve, vëllimin e lëndëve, dhe faktin se trajtimi i lëndëve Civile ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e publikut dhe rrit besueshmërinë e palëve në Institucionet tona. Gjyqtarëve i janë ndarë lëndët, dhe pas procedurave të dorëzimit të lëndëve në formë fizike, edhe të caktimit me sistemin SMIL, të njëjti gjatë këtij muaji do të fillojnë me trajtimin e lëndëve.

Një (1) Gjyqtare e cila ishte caktuar në Degën e Gjykatës në Suharekë, është transferuar në Gjykatë tjetër, dhe kjo situatë po krijon ngarkesë në lëndë dhe po ndryshon planifikimet për punë dhe organizimin e Gjykatës në Suharekë e cila është një shembull për organizim dhe efikasitet, mirëpo për shkak të ngarkesës së madhe nuk po arrihen synimet dhe qëllimet në këtë degë.

Gjithashtu Gjykata Themelore në Prizren do të ketë edhe 4 (katër) Gjyqtarë më shumë, pas dekretimit me datë 07 Prill, ashtu që numri i Përgjithshëm i Gjyqtarëve në Gjykatën Themelore në Prizren, dhe Degët Suharekë & Dragash, është 38 (përfshirë 4 Gjyqtarët e sapo dekretuar) të cilët janë në trajnimin e rregullt 6 mujor.

Kjo rrit nevojën për mbështetjen e Gjyqtarëve me bashkëpunëtor profesional dhe staf administrativ sikurse Zyrtar Ligjor, dhe Referentë, andaj shpresojmë që Sekretariat i KGJK-së ta ketë parasysh kërkesat që Gjykata i përcjell në KGJK për plotësimin e vendeve të punës.

Ndër të tjera, si kryetare e gjykatës në ditë të caktuara organizojmë “ditën e hapur” dhe presim në takim qytetarët dhe palët e interesuara, shqetësimet dhe kërkesat e të cilëve i adresojmë dhe i trajtojmë me gjyqtarët dhe stafin mbështetës.

Në tre mujorin e dytë rregullisht kemi pasur takime me gjyqtarët e divizioneve të caktuar veç e veç, ndërsa në fund të muajit Qershor, është mbajtur kolegjiumi i rregullt me gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional me qëllim që të gjithë të jenë prezent për shkak të pushimeve gjatë muajve korrik dhe Gusht, ku është diskutuar efikasiteti i punës. Gjithashtu në këtë kolegjium diskutim kryesor kanë qenë dy planet e KGJK-së për trajtimin e lëndëve me prioritet të lartë.

1.Zbatimi i Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025

Sa i përket Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 e kemi hartuar planin e veprimit për zbatimin e mirëfilltë të kësaj strategjie, në të cilin plan janë paraparë afatet kohore deri në fund të vitit 2023 për numrin e zgjidhjes së lëndëve sipas viteve, duke i njoftuar gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët për zbatim dhe janë verifikuar rezultatet e arritura në këtë drejtim.

Meqenëse, siç e dimë këto lëndë janë lëndë me shumë pengesa dhe problematikat e tyre, megjithatë gjyqtarët janë duke e respektuar prioritetin e lëndëve sipas planit dhe për një periudhë të shkurtër është vërejtur reflektimi në caktimin dhe zgjidhjen e këtyre lëndëve, ashtu që pas identifikimit të numrit të lëndëve më të vjetra se viti 2010 nga gjithsej 57 lëndë ka zbritur në 30, pra 27 lëndë janë zgjidhur dhe pjesa e mbetur e këtyre lëndëve janë caktuar si dhe janë ndërmarrë veprime nga ana e gjyqtarëve.

Ashtu siç e kemi paraparë edhe me planin e hartuar për zbatimin e Strategjisë, në tremujorin e III-të të vitit 2023 synohet që të caktohen dhe të përfundohen lëndët më të vjetra se viti 2016, për të cilin plan kemi duke mbajtur takime të rregullta në mënyrë që të jetë sa më efikas.

Referuar kësaj pike të diskutimit, ju njoftoj se gjatë tremujorit të II-të të vitit 2023, kemi përpiluar raporte të detajuara dhe kemi konstatuar gjendjen me lëndë aktive dhe në punë, ndarë në vite dhe natyrë të lëndëve.

Nga secili Gjyqtar kemi pranuar raport për lëndët që kanë në punë, duke i'u referuar kërkesave dhe detyrave që rrjedhin nga Plani Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi.

Tashmë kemi identifikuar të gjitha lëndët në zyrën e secilit Gjyqtar (Civile, Penale dhe Krime të Rënda), të cilat do të kenë fokus të veçantë në trajtimin e tyre konform detyrave nga Planet Strategjike.

Përformanca e Gjykatës – Departamenteve dhe Divizioneve e shprehur në normë efikasiteti në %.

Në tremujorin e II-rë të vitit 2023, në tërësi si gjykatë kemi rezultuar me rritje të efikasitetit, në bazë të përqindjeve në lëndët e pranuar dhe atyre të zgjidhura.

E shprehur dha paraqitur në % norma e efikasiteti është si në vijim:

Gjykata Themelore Prizren

PENALE

D. Krime të Rënda — Norma e zgjidhjes së lëndëve **133% (28 lëndë të zgjidhura)**

D. Mitur - Norma e zgjidhjes së lëndëve **138 % (29 lëndë të zgjidhura).**

Penale Përgjithshme – Norma e zgjidhjes së lëndëve **103 % (269 lëndë të zgjidhura).**

CIVILE

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve **98%**

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **62% (678 Lëndë të zgjidhura)**

JoKontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **128% (102 lëndë të zgjidhura)**

Përmbartimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **158% (1,055 Lëndë të zgjidhura)**

Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve **66% (478 Lëndë të zgjidhura).**

Pra në lëmine Penale kemi një normë efikasiteti në rritje nga muajt paraprak, sidomos në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe për të Mitur.

Ndërsa në Divizionin Civil ka një efikasitet të lartë të zgjidhjes së lëndëve, por kjo nuk nuk paraqet gjendjen reale në normë efikasiteti në formë statistikore për shkak të numrit të madh të lëndëve në ardhje, deri më dt. 30 qershor 2023 janë pranuar 2330 lëndë. Efikasitet të lartë kemi sidomos në lëndët përmbartimore ku qytetarët presin drejtpërdrejt realizimin e një të drejte, pasi që numri i lëndëve aktive ka rënë ndjeshëm, dhe deri në fund të vitit në lëndë të natyrës përmbartimore mund të jenë 150 lëndë aktive.

Kjo është rezultat i angazhimit të të gjithë gjyqtarëve në këtë divizion dhe rritjes së numri të bashkëpunëtorëve dhe ndarjes së punëve në mënyrë të barabartë edhe të Bashkëpunëtorëve Profesional që angazhohen me Gjyqtarët.

Për të mbajtur në rritje trendin e efikasitetit pos Gjyqtarëve dhe Bashkëpunëtorëve profesional gjithsesi që duhet plotësimi i vendeve të punës edhe në stafin administrativ dhe mbështetës. Për këtë në fillim të vitit 2023 kemi dërguar një kërkesë në KGJK, për plotësimin e vendeve të punës dhe mungesat që i ka Gjykata Themelore në Prizren dhe dega në Suharekë.

Për më tepër bashkëngjitur keni tabelat e ndara në mënyrë specifike trajtimin e lëndëve sipas natyrës.

Gjykata Themelore - Dega në Suharekë

Aktualisht në këtë gjykatë janë 4 gjyqtarë, dy në lëmine civile dhe dy në lëmine penale, kurse për lëndët e divizionit të kundërvajtjes që nga Janari i 2023 këto lëndë po i trajtojnë Gjyqtarët e Divizionit Penal.

Efikasiteti i shprehur në %.

Gjykata Themelore – Dega SUHAREKË

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 101%

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 39%. (153 Lëndë të zgjidhura)

JoKontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 63% (29 lëndë të zgjidhura)

Përmbartimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve 90% (78 Lëndë të zgjidhura)

Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve 338% (395 Lëndë të zgjidhura).

PENALE

Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve 105 % (91 lëndë të zgjidhura).

Duke marrë parasysh numrin e Gjyqtarëve ku gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) Gjyqtarë, dhe stafin administrativ, kjo Gjykatë tregon një efikasitet të lartë dhe një organizim shembullor të punës dhe ndarjes së barabartë të punës dhe lëndëve, mirëpo në normë efikasiteti në formë statistikore nuk shfaqet gjendja reale kjo për shkak të numrit të madh të lëndëve në ardhje, ku deri më dt.30 qershor 2023 janë pranuar 790 lëndë civile, përkundër faktit që është Degë e Gjykatës mbulon një territor dhe Komunë me numër të lartë të banorëve.

Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj gjykate Selajdin Gallapeni pret në takim palët dhe personat e interesuar, ku ankesat dhe kërkesat e të cilëve i adreson te gjyqtarët.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë përballet me mungesë të Gjyqtarëve aktualisht, për shkak siç e theksova pensionimit, dhe mos përmbushje në numrit të Gjyqtarëve, si dhe me mungesë të stafit administrativ, referentë, roje sigurimi dorëzues, dhe pozita të tjera të cilat shfaqin pengesa në arritjen e synimeve dhe përmbushjen e të gjitha detyrave me kohë.

Gjykata Themelore - Dega në Dragash

Në këtë gjykatë funksionojnë gjyqtari mbikëqyrës i cili njëkohësisht punon edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, kurse në degën në Dragash është i angazhuar në divizionin penal si dhe një gjyqtare e cila është e angazhuar në të gjitha lëmi.

Efikasiteti i shprehur në %.

Gjykata Themelore – Dega DRAGASH

Divizioni Civil – Norma e përgjithshme e zgjidhjes së lëndëve 118%

Kontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **26%. (31 Lëndë të zgjidhura)**
JoKontestimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **400% (8 lëndë të zgjidhura)**
Përmbartimore – Norma e zgjidhjes së lëndëve **89% (742 Lëndë të zgjidhura)**
Kundërvajtje – Norma e zgjidhjes së lëndëve **300% (51 Lëndë të zgjidhura).**

PENALE

Penale Përgjithshëm – Norma e zgjidhjes së lëndëve **29 % (5 lëndë të zgjidhura).**

PËR MË TEPËR BASHKËNGJITUR GJENI RAPORTE NË TABELA TË VECANTA:

RAPORTI për MOSHËN E LËNDËVE NË PRITJE

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL po ju paraqesim **gjendjen me lëndë aktive** në Departamente dhe Divizione deri më 30 qershor, dhe për **moshën e lëndëve në pritje më të vjetra se dy vite (24 muaj)** të cilat edhe janë prioritet i Planeve dhe Strategjive të KGJK për efikasitet dhe qasje në Drejtësi.

Gjykata Themelore në Prizren, në fund të qershorit 2023, ka lëndë në pritje si në vijim:

PENALE

Penale Përgjithshme – 2,510 lëndë nga ky numër 947 lëndë më të vjetra se dy vite.
Departamenti për Krime të Rënda - janë 177 lëndë në pritje, nga ky numër 41 lëndë më të vjetra se dy vite.
Departamenti për të Mitur – 130 lëndë në pritje, 82 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 Muaj).

CIVILE

KONTESTIMORE – janë 8387 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 2,314 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
JO KONTESTIMORE – janë 870 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 442 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
PËRMBARIMORE – sipas sistemit SMIL janë 1,796 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 292 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).
***Ky numër nuk është i saktë në bazë të raportit individual të Gjyqtarit Përmbartues tek i cili figurojnë 317 lëndë aktive.**
KUNDËRVAJTJE – janë 2,136 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 216 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

Gjykata Themelore – DEGA NË SUHAREKË

PENALE

Penale Përgjithshme – janë 490 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 141 lëndë më të vjetra se 2 vite.

CIVILE

KONTESTIMORE – janë 3,055 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 752 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

JO KONTESTIMORE – janë 82 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 26 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

PËRMBARIMORE – janë 1,533 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 132 lëndë më të vjetra se 2 vite.

KUNDËRVAJTJE – janë 1,015 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 108 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

Gjykata Themelore – DEGA NË DRAGASH

PENALE

Penale Përgjithshme – janë 275 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 51 lëndë më të vjetra se 2 vite.

CIVILE

KONTESTIMORE – janë 1,156 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 117 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

JO KONTESTIMORE – janë 73 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 15 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

PËRMBARIMORE – janë 455 lëndë aktive/në punë, nga ky numër janë 16 lëndë më të vjetra se 2 vite.

KUNDËRVAJTJE – janë 115 lëndë aktive/në punë, nga ky numër 15 lëndë më të vjetra se 2 vite (24 muaj).

*** Raportim për publikim të vendimeve;**

Publikimi i vendimeve Gjyqësore tashmë një detyrë dhe obligimi ligjor, të cilin Gjykata Themelore në Prizren e përmbush në harmoni me Udhëzimet Administrative.

Gjatë periudhës Prill – Maj Qershor, janë publikuar 907 vendime Gjyqësore.

Mesatarisht Gjykata Themelore në Prizren publikon ndërmjet 350-450 vendime në muaj, varësisht nga efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve.

Gjykata Themelore në Prizren në raportin e Lëvizjes Fol në bashkëpunim me mbështetjen e INL, ka pasur një vlerësim të mirë sa i përket publikimit të vendimeve që janë në përputhje me Udhëzimet Administrative.

Përpos vendimeve për rastet që trajtohen, Gjykata vazhdon të publikoj brenda afatit ligjor edhe vendimet për rastet disiplinore që trajtohen nga Autoriteti Kompetent.

Marrë në përgjithësi, në bazë të të dhënave nga numri i lëndëve të zgjidhura, përjashtimisht vendimet që nuk publikohen sipas udhëzimeve administrative, Gjykata Themelore në Prizren publikon të gjitha vendimet tjera që janë për tu publikuar, nga të gjitha Departamentet dhe Divizionet, duke respektuar 100% udhëzimet Administrative për publikimin e vendimeve Gjyqësore, pasi që kujdesemi që të mos publikojmë vetëm si numër por të kemi kujdes edhe në cilësinë e mënyrë së publikimit të vendimeve.

*** Referimi i rasteve Gjyqësore në ndërmjetësim;**

Gjatë tremujorit të II-të të vitit 2023 janë referuar për zgjidhje në Zyrën e Ndërmjetësimit 109 lëndë, ku 68 lëndë janë zgjidhur përmes ndërmjetësimit, prej tyre 68 lëndë të lëmisë penale dhe 6 lëndë të lëmisë civile, ndërsa për 37 lëndë nuk është arritur marrëveshje e ndërmjetësimit, si dhe rastet e tjera janë ende në shqyrtim.

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtoresh profesionale si referente për ndërmjetësim, dhe një praktikant/e, që ndihmon për trajtimin e rasteve të referuar në ndërmjetësim. (një zyrtare e angazhuar nga USAID, ka përfunduar angazhimin, dhe e falënderojmë partnerët e USAID për ndihmën e vazhdueshme.

Në Gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim.

Gjithashtu jemi duke planifikuar, por që ende nuk është vendosur që edhe në Gjykatën Themelore – Dega në Suharekë të krijojmë një hapësirë të veçantë dhe të caktojmë një zyrtar për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim, por deri më tani ende nuk janë plotësuar kushtet reale për këtë synim.

2. Zbatimi i Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimin të organizuar 2022-2024

Në Gjykatën Themelore në Prizren, janë gjithsej 14 lëndë aktive të korrupsionit dhe krimin të organizuar, ku gjatë tremujorit të dytë janë zgjidhur 4 raste të këtij lloji, e që lëndët që janë aktive po trajtohen me prioritet. Me qëllim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Plani Strategjik për zgjidhje efikase të këtyre lëndëve, jemi duke mbajtur takime të shpeshta për diskutim së bashku me gjyqtarët dhe për mënyrat se si të zbatohet në përpikmëri ky plan, e që në vazhdimësi është duke u zbatuar.

Momentalisht nuk ka ndonjë lëndë të kësaj natyre që është afër parashkrimit.

Gjithashtu në këtë Departament është rikthyer në rigjykim një rast (SHKOLLA), për një pikë të aktakuzës për një të akuzuar (në fillim kanë qenë 3 të akuzuar për disa pika të aktakuzës). Kjo lëndë nga Departamenti i Krimeve të Rënda, është bartur në Departamentin e Përgjithshëm për shkak të kompetencës sa i përket natyrës së veprës penale për të cilën rasti është kthyer në rivendosje.

Ashtu që në vitin 2023 kemi një rast aktiv i shënjestruar me shenjën "LV".

Në të gjitha takimet me Gjyqtarët e Divizioneve dhe kolegjiomet, në vazhdimësi kemi diskutuar për të evituar sa më shumë seanca jo produktive. Pra Gjyqtarët kanë kujdes maksimal që të njoftohen të gjitha palët në rast të dështimit të seancave me kohë, ashtu që edhe përmes e-mailit zyrtar të Gjykatës në vazhdimësi kemi komunikime me palë, avokatë dhe institucione të tjera të përfshira në procedurë, në rast kur dihet paraprakisht se do të dështon një seancë. Nga Departamenti i Krimeve të Rënda kemi kërkuar që të ketë caktim të seancave të njëpasnjëshme, dhe kjo është duke u praktikuar ashtu që për një rast caktohen 2-3 ditë seanca dhe është kërkuar kujdes i veçantë në caktimin e seancave në rastet që janë në fokus të Planeve Strategjike dhe rasteve me interes të lartë. Sa i përket shtyrjes së seancave në bazë të të dhënave të siguruar nga sistemi SMIL në Departamentin e Krimeve të Rënda, në tremujorin e II-të, janë shtyrë 19 seanca gjyqësore, ku shumica e seancave shtyhen për mungesë të palëve në procedurë, apo dëshmitarëve e një numër më i vogël me kërkesë të palëve në procedurë. Këto janë të dhënat të përpunuara nga sistemi SMIL për shtyerje të seancave.

3. Sa është duke u zbatuar rregullorja për norma

Rregullorja për normë që nga hyrja në fuqi ka filluar të zbatohet nga gjyqtarët, ku si fillim zbatimi i kësaj rregullore ka dhënë një efekt pozitiv sa i përket rritjes së zgjidhjes së lëndëve me prioritet, të cilat kanë numër të madh të pikëve, edhe pse ka lëndë që kanë pengesa, por kjo rregullore pavarësisht faktit që edhe mund të ketë ngarkuar më shumë gjyqtarët, ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në Zbatimin e Planit Strategjik 2022-2025.

Sa i përket lëndëve nga Kontrata Kolektive ka një rënie të numrit të rasteve në pritje sa ka qenë rreth 1,250, kjo si rezultat i zgjidhjes së rasteve të lëndëve me shujta, pagave jubilarë dhe konteste pune në forma tjera, pra pa shqyrtim kryesor të çështjes. Në këtë periudhë, secili Gjyqtar ka mesatarisht nga deri në 300 lëndë të kësaj natyre. Kemi pritur që me shkëputjen e kontratës kolektive në muajin Nëntor të vitit 2022, lëndë nga kjo natyrë do të kenë një rënie, mirëpo vazhdojmë të kemi arritje të lëndëve të reja që rrjedhin nga Kontrata kolektive, të cilat ndikojnë në efikasitetin dhe raportin statistikor në mënyrë negative. Gjyqtarët në bashkëpunim me bashkëpunëtorët janë udhëzuar që ti trajtojnë sa më shumë këto raste, në forma alternative në mënyrë që përfundimisht gjatë vitit 2023 të zgjidhen këto raste, dhe të fokusohemi në trajtimin e rasteve me prioritet për palët dhe qytetarët.

****Angazhimi i Bashkëpunëtorëve Profesional***

Që nga vitit 2022, si Kryetare e Gjykatës, në bashkëpunim me Gjyqtarët, kemi bërë shpërndarjen e Bashkëpunëtorëve Profesional për secilin Gjyqtar, me synim që secili gjyqtar të ketë nga një bashkëpunëtor profesional gjë që do të ndikojë drejtpërdrejtë në rritjen e efikasiteti dhe zgjidhjen e lëndëve që kanë qenë në pritje për përpilimin e vendimit. Bashkëpunëtorët janë të angazhuar në koordinim me gjyqtarët, ashtu që kënaqshëm po bëhet përpjekje për punë me efikasitet. Në Planin që e kemi hartuar për zbatimin e Planit Strategjik kemi angazhuar edhe bashkëpunëtorët që së bashku me gjyqtarët të identifikojnë lëndët me prioritet dhe të kujdesen për evitimin e pengesave për zgjidhjen e këtyre lëndëve përmes veprimeve të caktuara. Duhet të cekim se disa nga bashkëpunëtorët profesional përveç që punojnë me gjyqtarët punojnë edhe me punë tjera (një punon me kryetaren, një punon me procedurën e ndërmjetësimit, një punon me procedurën e asgjësimit dhe të gjithë bashkëpunëtorët profesional të Divizionit Penal punojnë me lëndët që kanë të bëjnë me kërkesat për shlyerje nga evidenca penale).

4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në GJTHPZ punohet nga referentët e caktuar për secilën lëmi, ashtu që për vendimet që janë gati për ekzekutim formohet lëndë dhe nga ana e gjykatës merren të gjitha veprimet e nevojshme që të ekzekutohen në kohë sa më të shpejtë të mundshme, në zyrën e ekzekutimeve penale, në rast të mos ekzekutimit në mënyrë vullnetare, lëshohen urdhëresa, urdhër arreste (për ekzekutimin e dënimeve me burg) si dhe veprime tjera.

Gjendja me ekzekutimin e vendimeve qëndron si vijon:

Gjykata Themelore Prizren

EDGJ (ekzekutime të dënimeve me gjobë) janë pranuar 170 lëndë për ekzekutim, janë kryer 146, ndërsa 259 lëndë janë në procedurë të ekzekutimit.

PED (ekzekutime të dënimeve me burg) janë pranuar 46 lëndë, janë ekzekutuar 37, si dhe 82 lëndë të mbetura në procedurë të ekzekutimit ku janë ndërmarr të gjitha veprimet nga ana e gjykatës.

Sa i përket ekzekutimit të lëndëve të kundërvajtjes në këtë tremujor janë pranuar 310 lëndë, janë ekzekutuar 118 lëndë, janë parashkruar 43 lëndë, ndërsa aktive janë gjithsej 801 lëndë (përfshirë atp të trashëguara nga viti 2022).

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

EDGJ (ekzekutime të dënimeve me gjobë) 30 të kryera, kurse janë pranuar 32 lëndë;

CP (shpenzime të paushallit gjyqësor) të ardhura 55, të përfunduara, ekzekutuara 67 lëndë.

PED (ekzekutime të dënimeve me burg) të ardhura 3 lëndë, 3 të ekzekutuara, si dhe 10 të mbetura në procedurë të ekzekutimit ku janë ndërmarr të gjitha veprimet nga ana e gjykatës.

Ndërsa është parashkruar një lëndë, i dënuar me 60 ditë burgim, për të cilën gjykata i ka ndërmerr të gjitha veprimet për ekzekutim.

5. Si po menaxhohet vijueshmëria në punë (hyrje – daljet), pushimet vjetore dhe pushimet mjekësore

Sa i përket vijueshmërisë në punë mund të themi se orari është duke u respektuar në mënyrë të rregullt nga ana e stafit dhe gjyqtarëve, ndërsa për pushimet vjetore dhe mjekësore kemi një evidencë të veçantë ku marrja e pushimeve bëhet me koordinimin ndërmjet stafit në mënyrë që të mos krijohet mungesë e cila do të shfaqte ngecje në zhvillimin e punës në gjykatë.

6. Si po administrohet Evidenca Penale – verifikimi i personave të dënuar, vula e plotfuqishmërisë dhe futja me kohë e të dhënave në sistem

Sa i përket administrimit të evidencës penale, gjithçka është duke shkuar në rregull, me rastin e lëshimit të certifikatave verifikohen personat e dënuar, ndërsa vula e plotfuqishmërisë dhe regjistrimi i të dhënave në sistem është duke u proceduar me kohë ndërsa sa i përket lëndëve pas ngarkimit të vendimit në sistem, lëndët pas ekspedim qëndrojnë akoma në zyrën e gjyqtarëve deri në pranimin e fletëdërgesave të palëve në procedurë, pastaj lënda dorëzohet te shkrimorja penale, ku referenti përkatës aktgjykimet i procedon me vulën e plotfuqishmërisë .

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

